AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION
DPKI
Nr. 05
537/24
02.04.24

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 02.04.2024, nxjerrë këtë:

VENDIM

I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-262/24, për zyrtarin z. Skender Kokollari, Sekretar në Fakultetit e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Arsyetim

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin z. Skender Kokollari, është trajtuar sipas procedurës së paparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-262/24), me të cilën është kërkuar inicimi i procedurës për konflikt të interesit ndaj z. Skender Kokollari, (tani) Sekretar në Fakultetit e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren (në vijim: UUHP), pasi që siç theksohet në raportimin e rastit, zyrtari në fjalë ka qenë anëtar i Komisionit rekrutues për vlerësimin e kandidatëve sipas konkursit nr. 01-679 të datës 22.12.2022, për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare, në të cilin konkurs është pranuar kandidatja T. Th., me shifrën e aplikimit 2-3-679, e cila gjithnjë sipas pretendimeve të raportuesit të rastit, është e afërme (kusherinë) e z. Skender Kokollari.

Ndër të tjera, raportuesi i rastit ka theksuar se: *"[...] z. Skender Kokollari zyrtari i cili ka pranuar aplikacionet, ka bërë regjistrimin e tyre, i ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e secilit kandidat dhe pasi i ka vlerësuar, e ka përgatitë listën e ngushtë, dhe i ka njoftuar kandidatët për të gjithë fazat rekrutuese. Ky anëtar i Komisionit dhe përgjegjës i burimeve njerëzore, kishte afërsi me kandidaten fituese por i njëjti ka qenë anëtar në komisionin vlerësues për testin me shkrim, dhe vetëm pasi është përfunduar testi me shkrim, ky anëtar i komisionit është tërhequr tek faza e vlerësimit me gojë për shkak të konfliktit të interesit. Ky veprim përbënë shkelje procedurale dhe paraqet konflikt interesi të pastër, dhe i njëjti është dashur të tërhiqet*

nga komisioni në momentin e shqyrtimit të aplikacioneve rrjedhimisht kur ka kuptuar se kushërira e tij është kandidate, e jo të tërhiqet pasi që e ka vlerësuar në test me shkrim, e ka vendosur të parën në listë, dhe pastaj është tërhequr. Duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë që keni në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, kërkoj nga ju që të shqyrtoni këtë rast dhe të ndërmerreni të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e veprimeve që janë kryer në konflikt të interesit, dhe që ndaj zyrtarëve përgjegjës poashtu të ndërmerrni veprimet e përcaktuara për rastet e veprimit në konflikt të interesit [...]".

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, përkatësisht vetëm pretendimet që lidhen me dyshimin për konflikt të interesit, përkitazi me pjesmarrjen e z. Skender Kokollari në cilësi të anëtarit të Komisionit rekrutues në vlerësimin e kandidatëve (vendimmarrje) sipas konkursit nr. 01-679 të datës 22.12.2022, për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare, si dhe pretendimet që lidhen me dyshimet se kandidatja e pranuar në këtë pozitë T. Th., është e afërme e zyrtarit në fjalë.

Agjencia nuk ka trajtuar pretendimet e raportuesit të cilat lidhen me (pa)rregullsinë dhe/apo (pa)ligjshmërinë e procesit për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare në UUHP, sipas konkursit nr. 01-679 të datës 22.12.2022, pasi që këto pretendime janë jashtë sferës së konfliktit të interesit dhe si të tilla nuk janë në mandat të Agjencisë.

Kësisoj, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-502/24, e ka njoftuar zyrtarin z. Skender Kokollari, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, zyrtari në fjalë është njoftuar edhe me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit dhe faktet për rastin e tij. I njëjti me shkrim ka konfirmuar se ka pranuar njoftimin për inicimin e procedurës dhe se është i njoftuar me rastin.

Përveç kësaj, më qëllim të sqarimit të situatës gjithnjë në kontest të zbatimit të dispozitave të LPKI-së dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06/02-277/24, ka kërkuar nga UUHP informata, sqarime dhe dokumentacionin relevant lidhur me gjithë procesin e Konkursit nr. 01-679, të datës 22.12.2022, për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare. UUHP, duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatat përmes shkresës zyrtare DPKI-06/02-277-1/24.

... si material plotësues në lidhje me çështjet e ngritura, UUHP përgjigjes si më lartë ia ka bashkangjitur dokumentacionin për konkursin nr. 01-679, të datës 22.12.2022, për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare.

Më pas, me qëllim të vërtetimit të lidhjes (eventuale) familjare përkatësisht afërsisë së z. Skender Kokollari me kandidaten e pranuar T. Th., Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06-392/24, ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Agjencia ka pranuar nga ARC - MPB përgjigjen përmes shkresës zyrtare DPKI-06-392-1/24.

Kësisoj, Agjencia pasi ka administruar si prova (vetëm provat që lidhen me pretendimet për konflikt të interesit) kërkesën e parashtruesit dhe dokumentacionin e bashkangjitur, përgjigjen zyrtare të pranuar nga UUHP dhe përgjigjen e pranuar nga ARC - MPB, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Më datë 22.12.2022, UUHP ka publikuar Konkursin Nr. 01-679, përveç pozitave tjera edhe për pozitën (III) Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare.

Me Vendimin nr. prot. 01-687, i datës 23.12.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të UUHP-së, është themeluar Komisioni rekrutues për vlerësimin e kandidatëve sipas konkursit nr. 01-679, të datës 22.12.2022, për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare. Sipas vendimit në fjalë, z. Skender Kokollari ka qenë anëtarë i komisionit si më lartë - përfaqësues i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ).

Më pas, me Vendimin nr. prot. 01-55, i datës 25.01.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm të UUHP-së, është ndryshuar pika II. e dispozitivit të Vendimit nr. prot. 01-687, i datës 23.12.2022, ashtu që z. Skender Kokollari është zëvendësuar me një anëtarë tjetër.

Sipas përgjigjes zyrtare të UUHP-së, në lidhje me zëvendësimin e z. Skender Kokollari, është sqaruar se: *"[...] Lidhur me dyshimin e pretenduar për konflikt interesi ju informoj si më poshtë: z. Skender Kokollari ka qenë anëtar ex-officio i komisionit sipas dispozitave të nenit 68 pika 5 e ligjit nr. 06/L-114 dhe të gjitha kompetencat që ka ushtruar në vlerësimin e dosjes si dhe testit me shkrim janë kompetenca që i njeh ky ligj. Pas fazës së testit me shkrim, si fazë e anonimitetit të kandidatëve, z. Skender Kokollari ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm të lirohet nga këto detyra që i'a ngarkon ligji, thjesht për shkaqe etike. Konstatojmë se edhe pse e kemi ditur që nuk ka asnjë element të konfliktit të interesit, kemi vepruar sipas kërkesës së NJMBNJ dhe të njëjtin e kemi liruar nga detyrat që ia ngarkon ligji [...]".*

Sipas Vendimit nr. prot. 03-55, i datës 01.02.2023, pas realizimit të procesit të rekrutimit lidhur me listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë, komisioni ka nxjerrë rezultatin përfundimtar, ashtu që kandidatja T. Th. është vlerësuar më së shumti me pikë.

Kundër vendimit si më lartë ka pasur një ankesë nga njëri prej kandidatëve, të cilën Komisioni i Ankesave në nivel të Universitetit, me Vendimin nr. prot. 02-130, të datës 27.02.2023, e ka refuzuar si të pabazuar.

Nga ankesa dhe vendimi si më lartë, rezulton se ndër pretendimet e parashtruara me ankesë ka qenë edhe ai për dyshimet për konflikt të interesit ndërmjet z. Skender Kokollari dhe kandidates së pranuar T. Th., të cilin pretendim e ka refuzuar komisioni i ankesave me arsyetimin se siç theksohet në vendim: *"[...] pretendimet e palës ankuese lidhur me konfliktin e interesit nuk qëndrojnë për faktin se nuk është konstatuar ndonjë konflikt i interesit [...]".*

Rrjedhimisht, bazuar në dokumentacionin e konkursit nr. 01-679, të dërguar nga UUHP, është evidente z. Skender Kokollari ka qenë pjesë e vendimmarrjes (përfshirë çastet paraprake të vendimmarrjes) në procesin e konkursit nr. 01-679, i datës 22.12.2022, për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare, në të cilën pozitë është pranuar kandidatja T. Th., sikurse është vlerësimi i dosjeve të kandidatëve dhe njoftimi për listën e ngushtë - preliminare (nr. prot. 03-23, i datës 13.01.2023), njoftimi për listën e ngushtë - përfundimtare (nr. prot. 03-30, i datës 17.01.2023), vlerësimi i kandidatëve për testin me

shkrim dhe njoftimi për rezultatet e testit me shkrim (nr. prot. 03-45, i datës 23.01.2023), Vendimi nr. prot. 03-55, i datës 01.02.2023, me të cilin komisioni ka nxjerrë rezultatin përfundimtar, ashtu që kandidatja T. Th. është vlerësuar më së shumti me pikë, si dhe veprime të tjera në realizimin e këtij konkursi.

Lidhur me afërsinë e z. Skender Kokollari me kandidaten e pranuar T. Th., nga përgjigja e ARC - MPB, rezulton se: *"[...] bazuar në të dhënat nga Regjistri Civil, ku si bazë për verifikim kemi përdorur trungun familjarë të shtetasve Skender Kokollari [...] dhe T. Th. [...] NUK kemi vërejtur se shtetasit e lartëshënuar kanë ndonjë lidhje familjare mes tyre".*

I. Në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, për shkak se një situatë e tillë nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo *për personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka **interes privat**, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së **interesit të tij privat** ose **të personave të afërm** me të lidhur me **vendimmarrjen** në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *"interesi privat i personit zyrtar - nënkupton **çfarëdo përparësie për personin zyrtar**, familjen e tij, **të afërmit**, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"*, dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: *"**Person i afërm me zyrtarin** është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, **të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt**, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin [...]."*

Përveç kësaj, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e definon nocionin vendimmarrje si: *"**çasti i fundit** i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato **çaste paraprake të vendimmarrjes** të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe **çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.**"*

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë, është fakt se z. Skender Kokollari në cilësi të anëtarit/përfaqësues i NJMBNJ të Komisionit rekrutues për vlerësimin e

kandidatëve, ka qenë pjesë e procesit vendimmarrës për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare, sipas konkursit nr. 01-679 të datës 22.12.2022, në të cilin konkurs është pranuar kandidatja T. Th., por në kuptim të dispozitave të sipërcituara, kandidatja e pranuar T. Th. nuk është person i afërm i zyrtarit në fjalë, pasi që siç u theksua më lartë, ARC - MPB nuk ka gjetur lidhje familjare ndërmjet tyre.

Rrjedhimisht, Agjencia ka konstatuar se pjesëmarrja e z. Skender Kokollari në procesin vendimmarrës si më lartë, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, për faktin se, së pari, nuk është gjetur dhe vërtetuar që zyrtari në fjalë të ketë pasur çfarëdo përparsie - interes privat për 'vendimmarrjen' e tij (vlerësimin e kandidatëve për pozitën Zyrtar për hartimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare, sipas konkursit nr. 01-679), së dyti, kandidatja e pranuar sipas këtij konkursi, nuk është person i afërm i tij.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: "*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*"

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Y'll Bulashkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit z. Skender Kokollari;
- Raportuesit të rastit;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)